


Janar-shtator 2011: përpunohen 147 mijë ton mallra më shumë se sa vitin e kaluar.

17.010.2011

---



Në kalatat e portit detar të Durrësit gjatë periudhës janar-shtator të këtij viti janë përpunuar 147 mijë ton mallra më shumë se sa e njejtë periudhë e vitit 2011. Burime zyrtare nga drejtoria e Autoritetit portual, bëjnë të ditur se gjatë këtij 9-mujori janë përpunuar afro 2.6 milion ton mallra gjithsej dhe se janë shënuar rritje prej përkatësisht 5 dhe 7 përqind në importet dhe në eksportet nga porti më i madh i vendit.

Sipas statistikave, në 9 muaj anijet dhe tragetet kanë transportuar afro 1 milion ton mallra drejt porteve të tjera të Evropës. Megjithë rënien e sasisë së kromit të eksportuar, gjatë periudhës 9-mujore janë nisur drejt vëndeve të tjerë 104 mijë ton më shumë çimento dhe 32 mijë ton më shumë llamarina të prodhuara në Shqipëri. Mbi 785 mijë ton mallra të ndryshme janë transportuar brenda kontejnerëve, numri i të cilëve në kalatat e portit gjatë periudhës janar-shtator ka arritur në 60.476 njësi TEU gjithsej.

Burimet bënë të ditur se tragetet kanë transportuar më shumë se 550 mijë mallra gjithsej, ku spikat rritja e sasisë së mallrave të eksportuara me 9 përqind, krahasuar me të njejtën periudhë të vitit 2010.

